



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 26 korrik 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Muhamet Mustafa.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Sami Kurteshi – Avokat i Popullit dhe Safet Hoxha –KRPP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës)- Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari – Opinioni i ZAP-it për këtë raport është i pakualifikuar me theksim të çështjes. Zyra e auditorit duhet të sqaroj çështjen e rekomandimeve nga viti i kaluar, kush e ka bërë këtë auditim? Çështja e donacioneve – nuk ka një plan për shfrytëzimin e donacioneve, kërkoi sqarim nga Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me këtë. Regjistrimi i pasurisë – është problematikë që po përsëritet te të gjitha Organizatat Buxhetore si dhe databaza e personelit. Dorëheqja e tre zyrtarëve të lartë. Auditimi i brendshëm nuk funksionon. Institucioni i Avokatit të Popullit ka tre vetura të regjistruara e në të vërtetë ka 11. Kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Murselj Haljilji – Nuk ka të dhëna për buxhetin përfundimtar të vitit 2009. Të dhënat në mënyrë konstante flitet se në vitin 2009 janë shpenzuar 12 mijë e 433, ndërsa në 2010 mbi 16 mijë. ZAP ka dhënë treguesin vetëm për donacionet në vitin 2010. Sa kanë pas në vitin 2009, pra a ekzistojnë të dhënat për vitin 2009?

Vlora Mehmeti, ZAP – Auditimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009, e ka kryer ZAP. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka kontrolle të duhura. Rekomandimi që nuk është adresuar fare është rekomandimi për donacionet- 90 mijë euro dhe kanë bërë shumë pak në këtë drejtim. Të dhënat e prezantura të viti 2009 janë prezantuar në raport –lidhur me donacionet. Këto donacione rrjedhin që nga viti 2005 dhe shfrytëzimi i këtyre donacioneve në vitin 2010 është 20%.

Sami Kurteshi – Institucioni i Avokatit të Popullit ka trashëguar donacione në vlerë prej rreth 90mijë euro. Si avokat i popullit nuk ka pas informacione se institucioni ka donacion d.m.th lidhur me këtë nuk është njoftuar nga menaxhmenti i kaluar. Qëllimi për të cili janë dhënë donacionet në vitin 2005 ka pushuar dhe kjo është arsyeja se pse është vështirë të shfrytëzohen. Donacionet janë të parapara për trajnime për përgatitje të stafit etj. Me ardhjen e drejtorit ekzekutiv ka kërkuar që të bëhet regjistrimi i pasurisë. Auditori i brendshëm - ka kërkuar nga disa OB të vogla që kjo të bëhet bashkërisht dhe deri më tani nuk ka pasur interesim. Dorëheqjet e bashkëpunëtorëve – interpretimi në këtë rast ka qenë joligjor dhe politik. Dorëheqja është bërë pikërisht për këto çështje që janë të gjetura të ZAP-it. Deklaratat e tyre kanë qenë politike.

Jashar Kastrati – Donacionet janë riaktivizuar dhe pjesa më e madhe janë aktivizuar gjatë vitit 2010 dhe e drejta e shfrytëzimit të tyre janë si mjete të lira për mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme. Ato donacione kanë filluar të shfrytëzohen për qëllim të konferencës. Ndërsa për vitin 2011 janë përcaktuar për nevoja të tjera. Regjistrimi i pasurisë – kjo është e realizuar dhe në fillim të vitit 2011 kjo është kryer. Kjo është vonuar për shkak të mungesë së stafit profesional. 5 telefonat nga ish zv.avokati i popullit i ka pasur në shfrytëzim dhe të cilat nuk janë kthyer. Kemi kërkuar me shkrim që të kthehen telefonat, por nuk ka përgjigje.

Ramiz Lladrovci – Opinioni i pakualifikuar me theksim të çështjes në këtë ka ndikuar rekomandimi i gjashtë i cili duhet të hiqet. Dhe pjesërisht edhe rekomandimi shtatë. Rekomandimet e vitit të kaluar – rekomandimi për auditor te brendshëm kjo e gjetur është dashur të mos ekzistoj, sepse kjo ka mundur të realizohet në bashkëpunim me NJHAQ. Nënshkrimi i kontratave për shërbime hoteliere pa procedurë të prokurimit – është dashur të bëni marrëveshje të paktën me 5 operator dhe pastaj të merrni në shfrytëzim shërbimet. Pagat dhe mëditjet – gjatë vitit 2010 kanë dhënë dorëheqje tre zyrtarë të lartë dhe kjo e gjetur nuk duhet të paraqitet fare, sepse më vonë prezantohet se avokati i popullit nuk i ka lejuar ata që të bëjnë çfarë të donë me buxhetin dhe institucionin. Moskthimi i pasurisë nga zv.avokati i popullit- si i ka shfrytëzuar 5 telefona, si mund të ndodhë kjo? Kjo çështje duhet t'i adresohet prokurorisë.

Armend Zemaj – Nga raporti shihet se Institucionit të Avokatit të Popullit i mungojnë kapacitetet e brendshme. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka një plan adekuat për shfrytëzimin e donacioneve dhe kjo trego mangësi menaxheriale. Shqetësuese janë blerjet përmes prokurimit. Kjo tregon se menaxhimi i brendshëm ka bërë shkelje ligjore. Furnizimi me derivate, nënshkrimi i kontratës për shërbime hoteliere pa procedurë të prokurimit nga drejtori ekzekutiv është shkelje ligjore. Nëse dikush mund të gjejë bazë ligjore lidhur me këtë atëherë mund të kërkohet që të hiqet ky rekomandim, por kjo është e ndaluar me ligj. Pastaj, shpenzimi i parasë së imët – kjo ju lejohet institucioneve, por nëse bëhet jo në pajtueshmëri me ligj, atëherë lenë hapësirë për dyshime për manipulime. Kjo tregon se në Institucionin e Avokatit të Popullit, mungojnë kapacitetet e brendshme. Kërkoi nga Institucioni i Avokatit të Popullit që të ndërmarrë masa të menjëhershme lidhur me këto dhe ta njoftoj Komisionin brenda afatit të caktuar.

Murselj Haljilji – Institucioni i Avokatit të Popullit ka shkelur ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare, sepse raporti nuk është hartuar në të dy gjuhët. Raporti i ZAP-it prezanton mjaftë të meta nga e kaluara. Pyeti: a ka formuar ky institucion Komision që do të konstatoi gjendjen e financave në këtë institucion për atë periudhë? A ka institucioni plan të shfrytëzimit të donacioneve? Institucioni ka shfrytëzuar donacionin për mallra dhe shërbime dhe po ashtu ka pasur buxhetin për mallra dhe shërbime- kjo është e dyfishuar. Shpenzimi i donacioneve- institucioni nuk ka personel profesional, ndërsa donacionet janë për ngritjen e kapaciteteve të institucionit. Kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Sami Kurteshi – Institucioni ka trashëguar staf joprofesional. Raporti nuk është përkthyer në gjuhën serbe, kjo për arsye se institucioni nuk ka kapacitete. Komision për kontrollim dhe auditim të brendshëm sidomos për shpenzimet e vitit 2006 deri në vitin 2008 nuk ka. Planifikim për trajnim nuk mund të bëjmë, sepse do të përpiqemi që të organizojmë trajnime vetëm sipas nevojës. Plan për shpenzimin e buxhetit dhe të donacioneve nuk ka.

Valbona Dibra – Institucioni i Avokatit të Popullit sigurisht që ka pasur plan, sepse pa pasur një plan nuk mund të marrë buxhet. Pyeti: Donacionet – a ka plan institucioni dhe a janë të dedikuara vetëm për trajnime të stafit dhe cili është qëllimi i tyre?

Jashar Kastrati – Për të bërë një plan duhet të kesh resurse të mjaftueshme. Institucioni ka qenë pa zyrtarë të personelit në kohën kur ka marrë pozitën e drejtorit për të kryer këtë detyrë ka angazhuar asistenten ekzekutive si zyrtarë të personelit. Kontrolli i brendshëm lidhet me ekzistimin direkt me një zyrtar të auditimit të brendshëm. Gjetjet janë si pasojë e mungesës së kapaciteteve profesionale – udhëheqësi i departamentit të prokurimit është me shkollë të mesme. Furnizimi me shërbime hoteliere- ne vitin 2009 kam gjetur 15 kontrata të njëjta, kam vazhduar njëjtë sepse më ka munguar ekipi që të kontrolloj. Donacionet – janë riaktivizuar dhe janë planifikuar për një konferencë. Ato shpenzimet janë bërë minimale.

Ramiz Lladrovci – Drejtori nuk ka të drejtë të kryej punën e zyrtarit certifikues. Menaxheri kryesor duhet t'i raportoj avokatit të popullit çdo tre muaj se paku, domethënë është e metë e menaxherëve që nuk kanë informuar avokatin e popullit lidhur me gjendjen. Bashkëpunimi me OB për auditor të brendshëm është i domosdoshëm. Disa të gjetura janë të pavend, sepse kjo gjendje në këtë institucion është trashëguar.

Qerkin Morina zv.auditor i përgjithshëm – ZAP ka zbutur performancën e institucionit të avokatit të popullit, sepse ky institucion duhet të ketë një kredibilitet të mirë në opinion. Institucioni nuk ka një plan lidhur me donacionet. Regjistrimi i pasurisë- nga 11 vetura kanë regjistruar vetëm tri. Rastet e prokurimit – nënshkrimi i kontratave e bënë zyrtari i prokurimit me përjashtim të kontratave të mëdha. Performanca – është bërë vlerësimi i performancës së punëtorëve, mirëpo në shtator ZAP do të bëjë auditme dhe ndoshta do ta analizoj më në detaje këtë.

Murselj Halilji- Shprehu shqetësimin se ZAP ka zbutur performancën e këtij institucioni, sepse në bazë të kësaj Komisioni duhet të marrë secilin raport të ZAP-it me rezervë. Çka do të thotë lehtësim sipas ZAP-it.

Qerkin Morina, zv.auditor i përgjithshëm – Fjalori është i zbutur, por nuk është hequr asgjë nga të gjeturat.

Kryetari – Propozoi që raporti të procedohet në Kuvend dhe të obligohet institucioni i Avokatit të Popullit që në afatin prej tre muajve, me raport me shkrim ta njoftoj Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ramiz Lladrovci – Tha se raporti nuk duhet të procedohet në seancë. Sepse nëse kërkon raport për tre muaj s'ka kuptim të procedohet në seancë. Në këtë rast ose duhet të presim raportin nga Avokati i Popullit ose raporti të procedohet në seancë.

Kryetari konstatoi se të pranishëm në sall ishin gjashtë deputet. Me pesë vota “ për” dhe një “kundër” Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

1. *Obligohet Institucioni i Avokatit të Popullit që në afatin prej tre muajve, me raport me shkrim ta njoftoj Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*
2. *Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu kryetar i Komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari - Kryetari –Opinionin është i pakualifikuar. Kush ka bërë auditimin e vitit të kaluar dhe a janë adresuar ato. Kjo pyetje për ZAP-in. Prokurimi ka vërejtje- nuk kanë pasur dokumentacion adekuat, ka bërë ndarje të një blerjeje, pse ka ndodhur kjo dhe si ka ndodhur kjo? Vizita në një seminarë pa ftesë, domethënë udhëtimi ka qenë privat, jozyrtarë. Shpenzimet telefonike janë të larta, pastaj përdorimi i veturave 24 orë. Dosja e personelit, nuk keni njësi të auditimit të brendshëm dhe auditor. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Bezat Halilaj – KRPP për herë të fundit nga ZAP-i është audituar në vitin 2006, kjo në mungesë të kapaciteteve. Në vitin 2008 dhe 2007 nuk ka pas auditime. Është hera e parë që në vitin 2010 KRPP auditohet nga ZAP-i.

Safet Hoxha - KRPP është pajtuar me të gjeturat e ZAP-it. Ndarja e blerjes - është fjala dislokimin në objektin e ri me qira. Është nxjerr një Udhëzim dhe qëllimi ka qenë që për blerjet të caktohet kuota, sasia, pra të mos bëhet për njësi dhe kur jemi vendosur ne objekt, pronari ka lëshuar edhe një pjesë tjetër. Vlera ka qenë e vogël 364 euro dhe për këtë është parë e paarsyeshme që të shpallet procedurë e re e prokurimit. Vizita - është fjala e një vizite të një anëtarit të Bordit në SIGMA në Turqi. Domethënë ka qenë pjesë e SIGMËS, sepse takimi ka vazhduar me takimi e Komitetit të drejtuesve përfitues të projektit edhe për dy ditë. Shpenzimet e telefonisë mobile - një anëtarë i Bordit i komunitetit serb ka pas shpenzime të mëdha dhe personalisht ka kërkuar që t'i ndalet qasja, sepse ka konsideruar që dikush ka pas kycje ilegale në numrin e saj. Për telefonat mobil ekziston një Rregullore. Problemi më i madh është çështja e auditimit të brendshëm. KRPP ka mungesë të ekspertëve dhe punësimi i një auditori do të merrte

dy tre vende te ekspertëve. Kjo është për pasojë si mungesë e buxhetit - jemi duke bërë përpjekje që kjo të rregullohet, por megjithatë edhe kjo çështje është mjaft komplekse.

Murselj Haljilji – Çështja e telefonave - do të duhej të sqarohet në raport. Nëse dikush ka shfrytëzuar telefoninë, atëherë barra bie prapë mbi këtë, kjo do të duhej të paraqitej në raport. Sa është limiti i përdorimit të parasë në telefoni?

Afrim Hoti – Në katër raste të dosjes së personelit mungojnë të dhënat si: dëshmi për shkollim vlerësim vjetror të punës përshkrim i vendit të punës kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Ramiz Lladrovci – Botimet e publikimeve - nuk ka pasur nevojë që të dal e gjetur, përdorimi i veturave zyrtare nga anëtarët e Bordit - kjo është e përcaktuar me Udhëzim. Kjo e gjetur nuk është dashur të ekzistoj. Dosjet e personelit duhet pasur dosje të sakta. Përgëzoi KRPP-në për punën e bërë. Sipas raportit të ZAP-it është shkëlur Udhëzimi Administrativ për përdorim të veturave. Kërkoi sqarim nga auditori lidhur me këtë.

Safet Hoxha – KRPP nuk ka mundur të dëshmoj se ka pasur kycje ilegale në këtë numër por kemi arritur të bëjmë ndaljen duke ndaluar përdorimin e telefonit fiks-mobil vetëm dy numra mund të funksionojnë. Mbushje në telefon mbi bazën e rregullores punëtorëve ju ndahen 30 euro ndërsa anëtarët e bordit nga 100euro. Dosja e personelit realisht vërejtja është e qëndrueshme, fjala është për tre punëtorë që kanë lëshuar punën. Botimet e publikimeve nuk ka pasur kërkesë, por disa vërejtje janë të natyrës administrative. Udhëzimi për shfrytëzim të veturave i referohet personave në qeveri, ndërsa Bordi është i propozuar prej Qeverie dhe i emëruar nga Kuvendi dhe në bazë të kësaj nuk mund të ndalojmë përdorimin e veturave. Udhëzimi nuk përfshinë të zgjedhurit e bordeve. Kjo është trashëguar dhe nuk kemi ndërhyrë në këtë çështje.

Bezat Halilaj – Udhëtimi zyrtarë mungesa e dëshmisë – dëshmi për shpenzim të parasë publike janë gjurmët dhe në këtë rast nuk është siguruar dëshmia. Shpenzimet e telefonisë- ekziston Udhëzimi 03/2008 i cili rregullon formën e shpenzimeve të telefonisë dhe kategoritë, këtu nuk hyn pjesa e Bordit. Udhëzimi për përdorimin e veturave zyrtare – çështja ligjore për përdorim të veturave nuk është e rregulluar. Udhëzimi 04 rregullon këtë, por këtu nuk është përfshirë KRPP, dhe duke pasur parasysh mungesën e një ligji për KRPP dhe ligjet tjera, ka bërë që auditori të ketë këtë të gjetur se KRPP ka vepruar në kundërshtim me Ligjin.

Alma Lama – Pyeti: a është vënë nënë presion KRPP, nga Qeveria apo nga OE për tenderët e ndryshëm?

Safet Hoxha – Deri më tani nuk ka pasur asnjë formë të presionit nga askush.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

2. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri mori këtë

VENDIM

1. *Ditën e mërkurë datë 27 Korrik 2011, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike do të organizoj një drekë pune - jashtë ndërtesës së Kuvendit, me përfaqësues nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm.*
2. *Shpenzimet barten nga Buxheti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Ali Sadriu